


GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PEJË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit: Dan Muqkurtaç nga Peja, për kundërvajtje nga neni 6.2 i sanksionuar me nenin 16 paragrafi 1. 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik Nr.03/L -151, në bazë të neneve 30,123,dhe 195 të Ligjit për Kundërvajtjet me datë 04.01.2012,morri këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI:

Dan Isuf Muqkurtaç i lindur me 2.10.1958 në f.Bogë KK Pejë me banim në Pejë, rr. Jeta Dedusha nr 46 , ekonomist i diplomuar,i martuar, baba i tre fëmijëve,i gjendjes së mesme social ekonomike, jo i dënuar më parë.

		REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY PRISHTINE
Dep.	DPK/DMP	Nr. Prot
Dep.		Br Prot
		Prot No
Nr. I faq.	02	Data
Broj stranica		Datum
Nr. pages		12.03.2012

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse: Si zyrtar i lartë publik në pozitën K.Z.F në kompaninë e ujitjes "Drini i Bardhë" Sh.A në Pejë, brenda afatit të përcaktuar ligjor gjer me datë 31.03.2011,nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë tek Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, -me çka ka bërë kundërvajtje nga neni 6.2 i sanksionuar me nenin 16. paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik Nr.03 /L-151

Andaj në bazë të dispozitave të cekura ligjore

DËNOHET

ME DENIM NË TË HOLLA në shumë prej 300 (treqind) € të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej njëzet ditësh duke llogaritur 15 € në një ditë burg. I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve paushallë të paguaj shumën prej 5 €,në të njëjtin afat sikurse dënimin. Nga një ekzemplar i aktvendimit u dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

Arsyetim

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-3194/11 të datës 14.07.2011, kundër të pandehurit të lartcekur për shkak të kundërvajtjes të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata duke vepruar sipas kërkesës ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në seancë verbale ka dëgjuar të pandehurin, i cili në mbrojtjen e vet deklaroi: Është e vërtetë se nuk e kam bërë deklarimin e pasurisë,njoftimin nga AKK e kam pranuar përmes postes elektronike me datë 28.03.2011 në orën 23, email e kam hapur pas tri ditësh kur ka skaduar afati i përcaktuar ligjor për deklarim të pasurisë. Meqë

marrëdhënien e punës në kompaninë "Drini i Bardhë" e kam shkëputur me datë 01.01.2011, kam menduar se nuk e kam për obligim ta deklaroj pasurinë. Më tej shtoi se kryeshefi ekzekutiv i kompanisë Milazim Shatri apo dikush nga drejtoret e bordit ka pasur obligim ta njoftoj.

Për hir të vërtetimit të gjendjes faktike gjykata dëgjoji në cilësinë e dëshmitarit Milazim Shatri, kryeshef ekzekutiv në kompaninë "Drini i Bardhë" i cili deklaroi se nga pozita që mban nuk ka pas obligim ta njoftoj të pandehurin për obligimin e deklarimit të pasurisë, dhe shtoi se i pandehuri nga agjencia është njoftuar përmes postes elektronike.


Gjykata e shqyrtoi dhe vlerësoi mbrojtjen e të pandehurit, deklaratën e dëshmitarit si dhe të dhënat nga shkresat tjera të lendes, dhe nga ato të dhëna konstatoi se i pandehuri është kryes i kundërvajtjes e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka u shpall përgjegjës dhe u dënua si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me bindje se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi ndëshkimor që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të njëjtë apo të ngjashme.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U vendos në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Pejë, me datë 04.01.2012.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës kundërvajtëse dhe i pandehuri kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga data e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate pa pagesë takse.



Gjyqtarja
Hidajet Deryishi